



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.11.2023

**MBLEDHJA Nr. 61,**  
**Datë 01.12.2023, ora 10:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 01.12.2023, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 61 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-it të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 22.11.2023.
2. Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Karavasta Solar” shpk për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Polemi.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” shpk për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.126, datë 31.05.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” shpk për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” shpk, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” shpk, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM**  
**ANËTARI I BORDIT**  
**Erjola SADUSHI**